



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:100371
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05483066

A.C.nr.4884/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryetar, Enes Mehmeti, dhe Hysni Bardheci, anëtar, në çështjen juridike të paditëses B.M. nga fshati J... , Komuna e Pejës, të cilën e përfaqëson B.M., avokat me seli në Komuna Pejë, kundër të paditurave Kompania e Sigurimeve “E...” me seli në rruga ... nr..., Komuna Prishtinë dhe Kompania e Sigurimeve “I...” me seli në Komuna Prishtinë, në çështjen kontestimore lidhur me kompensimin e dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës Kompania e Sigurimeve “E...” me seli në rruga ... nr..., Komuna Prishtinë, të parashtuar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.622/18 datë 31.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 18.03.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë, ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “E...” me seli në rruga ... nr..., Komuna Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.622/18 datë 31.03.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.622/18 datë 31.03.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I. PJESRISHTË APROVOHET, kërkesëpadisë e paditëses B.M., nga fshati J... Komuna e Pejës,

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E...” në Prishtinë , paditëses B.M. nga J... , Komuna e Pejës, t’ia kompensojnë dëmin , nga baza e auto përgjegjësisë, për aksidentin e ndodhur me datë 10.02.2018, në shumën e specifikuar si me poshtë:

Dëmi jo material:

Në emër te dhimbjes fizike- trupore, shumën 1500€

Në emër te frikës, për te gjitha llojet shumen prej 1000€

Demi material:

Shpenzimet e mjekimit shumen prej 50 €

Shpenzimet për kujdes dhe ndihmë te huaj shumen prej 70€

Shpenzimet për ushqim e përforcuar në shumen prej 50 €

DETYROHET: e paditurat Kompania e Sigurimeve “E...” në Prishtinë, që presimet e cekura në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimit, paditëses t’ia paguajnë, me kamatë ligjore në shkalle prej 8%, të llogaritur nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit dt.09.04.2021, e deri ne pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1.139.00€, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh, me ditën e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

REFUZOHET, kërkesëpadia e paditëses , përtej pjesës aprovues me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E...” ne Prishtinë, t’ia paguajnë, në emër të dhimbjeve shpirtëror shumën prej 1000€, për frikë shumë prej 900€, për ndihmë dhe kujdesin e huaj shumën prej 30€, ushqim të përforcuar 30€, shpenzimet e mjekimit për terapi fizikale shumën prej 200€, si e pa bazuar.

REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura KS,,I..., në Prishtinë, në mënyrë solidarë me të paditurës KS,, E..., në Prishtinë, t’ia kompensojnë dëmin e shkaktuar në aksidentin e datës 10.02.2018, si e pa bazuar...”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të: konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që ta aprovoj ankesën e të paditurës, dhe ta prishë aktgjykimin e atakuar ashtu që lëndën t’ia kthejë Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi me propozim Gjykatës së Apelit që të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet aktgjykimi.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

- Ankesa e të paditurës, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja B.M. nga Komuna Pejë, me datë 21.06.2018, ka paraqitur padi, ndërsa me datë 11.02.2021 ka parashtruar parashtresë për precizim të kërkesëpadisë, ndaj të paditurave, me kërkesë për kompensimin e dëmit.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, dhe pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave, ka marrë aktgjykim C.nr.622/18 datë 31.03.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimin të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se: *“... Gjykata nga provat e nxjerra, erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditëses, është e bazuar dhe gjënë mbështetje në dispozitat e nenit 136, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, në të cilin nenë thuhet se kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë t ia kompensoi dëmin nëse nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij, si dhe dispozita e nenit 169 të të njëjtit ligj, parashihet se personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendos gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi, e në rast se nuk rivendoset gjendja e mëparshme, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të jap shpërblim në të holla, dhe nenit 170 parashihet se “detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagës që nga momenti i shkaktimi të dëmit, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi...”*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimin, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, dhe nuk është kontestuar baza juridike me pretendimet ankimore nga e paditura, andaj Gjykata e Apelit vlerëson se gjendja faktike në këtë çështje është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, dhe kështu e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen në këtë çështje juridike, për të cilat arsye aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar si reale shumën sa i përket vendosjes së kompensimit të paditëses për dëmin material, dhe jo material ku edhe e ka vërtetuar aktgjykimin e atakuar, pasi në bazë të mendimit të ekspertëve mjekësor Dr. E.M. Ortoped, të cilët ekspertë kanë konstatuar se në bazë të ekzaminimit të jashtëm të paditëses dhe në bazë të dokumentacionit që është prezantuar dhe atë ajo e emergjencës së Spitalit në Pejë si dhe raporteve mjekësorë kanë konstatuar se paditësja B.M.si pësojë e aksidentit të komunikacionit me datë 10.02.2018, ka pësuar ndrydhje të kokës, të hundës, çafës, si dhe regjionalit torakal (gjoksit) gjurit të djathtë, natyra e lëndimeve të lehta, po ashtu eksperti ka konstatuar se paditësja nga ky aksident ka përjetuar dhembje të intensitet tejet të lartë në kohëzgjatje prej 2 orëve, dhimbje të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 24 orëve, dhimbje të intensitetit të ulët në kohëzgjatje ka ende kohë pas kohe dhe i menaxhon me barna. Ndihma e personit të huaj ishte e nevojshme në kohëzgjatje prej 10 ditëve, ushqimi i përforcuar ishte i nevojshëm në kohëzgjatje prej 7 ditëve. Ndërsa nga mendimi i Ekspertit Dr. M.H., Psikiatër, vërtetohet se në lidhje me frikën e përjetuar si pasojë e aksidentit në bazë të dokumentacionit mjekësorë si dhe ekzaminimit direkt të paditëses B.M., ka konstatuar se paditësja ka përjetuar frikë primare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 2 minutave, frikë sekondare me intensitet të lartë ka pasur në kohëzgjatje prej 2 orëve, frikë sekondare me intensitet të mesëm ka pasur në periudhën kohore gjerë në 4 javë, frikë sekondare me intensitet të ulët ka pasur në periudhën kohore gjerë në 3 muaj, gjendje faktike kjo e vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Në nenin 169 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në mënyrë decisive thuhet se *"Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi"*.

Ndërsa në nenin 179 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndër të tjera thuhet se *"Kush i shkaktton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë..."*.

Nuk qëndrojnë pretendimet për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që gjykata e shkallës së parë ka pranuar të gjitha propozimet e palëve ndërgjyqësore për administrimin e provave të propozuara nga to me të cilat gjykata i ka provuar faktet vendimtare të çështjes sipas të cilave ka vendosur për themelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit i vlerëson si të pa bazuara pretendimet në ankesë të palës së paditur se Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, sa i përket lartësisë së kompensimit, pasi vlerëson se shumatat e gjykuara nga Gjykata në shkallë të parë, janë reale duke u bazuar edhe në lëndimet e pësuar nga paditësja.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimin i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Numri i lëndës: 2019:100371
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05483066

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.4884/2021 datë 18.03.2024

Kryetari i kolegjit – gjyqtari,
Bujar Muzaqi